

BASHKIA KORÇE  
NR 2427 PROT  
D ATA 10/03/2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE  
NJERËZORE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Korçë, më \_\_\_\_ .03.2026

### NJOFTIM

**“SHPALLJE KONKURSI, PËR PËRZGJEDHJEN NDËRMJET KONKURIMIT TË  
SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI DESTINACION TURISTIK”**

Bazuar në nenin 9 pika 1.1 gërma “a”, 64 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë Nr. 13 dt 29.01.2026 “Mbi përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen nëpërmjet konkurrimit të subjektit që do të promovojë korçën si destinacion turistik”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr 1480 Prot dt 12.02.2026 dhe Nr. 133 Prot dt 12.02.2026 “Për ngritjen e komisionit i cili do të ndjekë procedurën e përzgjedhjes të subjektit që do të promovojë Korçën si destinacion turistik”, Vendimit nr. \_\_\_\_ dt. 06.03.2026 të Kryetarit të Bashkisë Korçë, Bashkia Korçë njofton të gjithë subjektet e interesuara se shpall konkursin, për përzgjedhjen ndërmjet konkurimit të subjektit që do të promovojë Korçën si destinacion turistik

Subjektet duhet të përmbushin të gjitha kriteret bashkalidhur këtij njoftimi.

Kriteret e nevojshme mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e OJF që do të promovojë Korçën si destinacion turistik si më poshtë:

### KRITERET E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTIT

#### KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik |(OJF)i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi ( provuar me vendim gjykatë);
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me turizmin, shërbimet informative turistike, marketingun turistik ose fusha të ngjashme;( vendim gjykatë)
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata)

- Të mos jetë I denuar me vendim të formës së prerë (certifikate e gjendjes gjyqësore/ose e ngjashme)

#### KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të informimit turistik ose shërbimeve të ngjashme (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë turistike locale (diplome, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të Pikës së Informimit Turistik, mënyrës si do asistojë bizneset në menaxhimin e kapaciteteve turistike, si do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme locale, kombetare dhe nderkombetare, dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut turistik;
- Të ketë minimum 10 vite eksperiencë në fushën e turizimit.

#### KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme

Për kriteret e sipërcituara subjekti duhet të paraqesë dokumentacioni e kërkuar për secilin kriter në origjinal ose i njehsuar me origjinalin.

Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

#### PROCEDURA E KONKURIMIT

- Shpallja e thirrjes publike nga Bashkia Korçë në faqen zyrtare të ëëbit të Bashkisë Korçë dhe afishim në stendën e njoftimeve;
- Shpallja do të qëndrojë e afishuar/publikuar për një afatit 2 javor nga data e afishimit;
- Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë aplikimet brenda afatit dy javor në zvrën e Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zafi të mbyllur;
- Vlerësimi i aplikimeve të bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë;

- Renditja e subjekteve do të bëhet sipas pikëzimit të kriterëve; Grupi i punës ngritur me urdher të kryetarit i paraqet raportin e vlerësimit kryetarit për miratim.
- Kryetari shpall fituesin me vendim dhe nënshkruan marrëveshjen përkatëse.

Subjekti që do të përzgjidhet fitues do të nënshkruajë marrëveshje me Bashkinë Korçë për një afat 3 vjeçar nga data e nënshkrimit.

Bashkia Korçë do të japë me huapërdorje për subjektin fitues, objekti me sipërfaqe 16.6 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë Nr. 2/492 vol 32 faqe 100, ZK 8561 për një afat 3 vjeçar, aq sa do të zgjasë dhe marrëveshja e bashkëpunimit.

Subjektet që kanë shprehur interes, kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së dokumentacionit nëpërmjet përfaqësuesit apo personave të autorizuar.

Shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar do të bëhet në Sallën e Mbledhjes, Kati I, në Bashkinë Korçë, pas kalimit të afatit dy javor nga afishimi.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë dokumentacion, i cili do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Qëllimi i publikimit të këtij njoftimi është venia në dijeni e të gjithë subjekteve të interesuara, të cilët shprehin interes dhe përmbushin kriteret, për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm dhe të sipërcituara.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

Drejtoria e Mardhënieve me Publikun \_\_\_\_\_

